

BULETIN Nr. 1
Shtator – Nëntor 2018

INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET





Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 1

Integritet Llogaridhënie

Partneritete

Shtator – Nëntor 2018

Pikat e kontaktit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit:

Drejtues i Parë, Shkëlqim Saço, Shef i Sektorit të Planifikimit Strategjik dhe Studimeve

Kryekomisar, Arben Gjergji, Specialist në Drejtorinë e Standarteve Profesionale

Kryekomisar, Roland Alushani, Shef Sektori i Policimit në Komunitet

Komisar, Oltion Agolli, Shefi i Komisariatit Nr. 1

Nënkomisar, Dilaver Kalaja, Koordinator i Grupit të Punës për Planin e Integritetit në Komisariatit Nr. 1

Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:

Rovena Sulstarova, Menaxhere Projekti

Besjana Kuci, Konsulente e Komunikimit

Dalina Jashari, Kontribuese

Redion Qirjazi, Kontribues

Armela Xhaho, Kontribuese

Sotiraq Hroni, Konsulent i Lartë

Elsa Toska, Eksperte Ligjore e Etikës dhe Integritetit

Erald Bezhani, Ekspert i Menaxhimit të Riskut Institucional

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinioneve, përfaqësuesit e institucioneve vendore mund të na kontaktojnë në adresën e email: info@idmalbania.org ose tel: 042400241

NË VEND TË HYRJES 4

Mesazhet kryesore të fjalës së Ambasadores së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, znj. Guusje Korthals Altes 5

NË FOKUS 6

Policia Berat: Vendosija e një marrëdhënieje të re mes policisë dhe qytetarëve për një raport më të mirë besimi dhe kontributi në funksion të rendit dhe sigurisë. 7

Pogradec: Shefi i komisarit Z. Nikollaq Palla: “Nëse ju nuk bëni vërejtje për punën tonë, policia nuk mund të përmirësohet! Na ndihmoni që t’ju shërbejmë më mirë!” 8

Takimi Llogaridhënës në Kurbën: Neglizhimi i konflikteve banale çon në krime të rënda dhe në gjakmarrje 9

Korçë: Informimi i komunitetit është thelbësor për të nxitur raportimin nga ana e qytetarëve të shkeljeve të ligjit 10

PLANI I INTEGRITETIT 12

Trajnimi për Planin e Integritetit në Komisariatit Nr.1-Tiranë 14

PRAKTIKA TË MIRA NDËRKOMBËTARE 15
Modeli i Aleancës së Sigurisë në Rotterdam

Pse një Buletin?

“Integritet-Llogaridhënie-Partneritet” është mediumi që synon të ndajë përvojat në kuadër të sipërmarrjes të IDM. Ai i shërben publikimit të eksperiencave dhe synon të sensibilizojë, nxisë debatin dhe ndikojë në ndërgjegjësimin e aktorëve për politika sa më efektive për forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit.

Eksperiencia deri tani dëshmon se institucionet vendore si policia, bashkia dhe prokuroria kanë mbështetur plotësisht këtë qasje shumë-aktoriale. Të gjithë aktorët e tjerë vendorë, arsimi, biznesi, shoqëria civile e të tjerë e quajnë modelin si “përvojë e munguar”. Edhe qytetarët pjesëmarrës kanë vlerësuar këtë risi. Buletini do të mbështesë përvojat e bashkëpunimit të trekendëshit të artë edhe me shkrime të ndryshme nga praktika të mira ndërkombëtare.

Buletini do të jetë gjithashtu një përvojë e re për të gjithë lexuesit në shpalosjen e metodologjisë dhe praktikës për ndërtimin e një plani integriteti. Me këtë rast, duhet përmendur se policia e shtetit është i pari institucion në vend që po piloton një plan të tillë.

Bëhuni pjesë e këtij ndryshimi përmes kontributit dhe opinionit tuaj për përmbajtjen e këtij buletini nëpërmjet komunikimit me botuesit tek info@idmalbania.org.

Falënderim për partnerët dhe donatorin!

Instituti për Demokraci dhe Ndermjetesim (IDM) shpreh vlerësimin për Policinë e Shtetit për mbështetjen dhe partneritetin në këtë projekt të rëndësishëm. Gjithashtu, vlerësojmë lart mbështetjen nga Prokuroria e Përgjithshme dhe gjithë prokurorët e rretheve, të cilët për herë të parë u investuan në një takim llogaridhënës me qytetarët. Bashkitë e përfshira deri më tani kanë shfaqur angazhim të plotë në organizimin e takimeve vendore. Partneriteti mes tyre mbetet një objektiv konkret për tu zhvilluar më tej.

IDM shpreh mirënjohjen për Ministrinë e Jashtme të Mbretërisë së Holandës për mbështetjen ndaj shoqërisë civile dhe vendit në luftën kundër korrupsionit, mirëqeverisjes dhe demokracisë.

NË VEND TË HYRJES

IDM vjen në këtë program të ri bashkëpunimi me Policinë e Shtetit pas një përvoje mjaft të gjatë pune dhe me ide të qarta në përballjen e sfidave të organizatës policore të orientuara drejt forcimit të integritetit, një menaxhimi më efikas, llogaridhënies publike dhe partneriteteve vendore për parandalimin e krimit. Njëherësh, fokusi i rëndësishëm i punës do të jetë zhvillimi i politikave përmes evidencave në çështje që kanë të bëjnë me etikën, integritetin dhe zhvillimin e metejshëm të organizatës së policisë.

Projekti “Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit” ka nisur zbatimin e tij me disa synime kryesore:

Policia e Shtetit është institucioni i parë në vend ku po pilotohet një plan integriteti. Jemi shpresëplotë që bashkëpunimi i IDM me Komisaratin Nr. 1 të kryeqytetit në ngritjen e kapaciteteve, përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit do të jetë një histori suksesi. Kuptohet jo çdo gjë është e lehtë. Sfidat mbetet besimi në ndryshim dhe motivimi për tu përfshirë. Le të shpresojmë se përmes këtij buletini do të rrisim kuptueshmërinë dhe mbështetjen për një plan integriteti që ndërtohet jo nga lartë, por që pritet të hartohet nga vetë organizata policore, për tu zbatuar prej saj.

Takimet llogaridhëse po sjellin një model të ri të bashkëpunimit, përgjegjshmërisë reciproke së institucioneve dhe llogaridhënies publike para qytetarëve në nivel vendor. Aleanca për Siguri Vendore apo siç mund të quhet ndryshe “Trekëndëshi i Artë” i institucioneve si bashkia, policia dhe prokuroria është ndoshta mekanizmi i munguar për parandalimin e krimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë vendore për zbatimin e ligjit. Përvoja e deritanishme dëshmon se drejtues të policisë, kryetar të bashkive dhe prokurorët vendorë kanë mirëpritur dhe kanë vlerësuar nevojën për këto takime. Nga komunikimet publike me qytetarët, këshilltarët bashkiakë, përfaqësuesit e institucioneve vendore, kryeqytet, përfaqësues të institucioneve arsimore, bordeve të nxënësve dhe prindërve, përfaqësues të biznesit, shoqërisë civile dhe medias evidentuan një sërë problemesh dhe shqetësimesh për rendin dhe sigurinë publike. Shpresojmë që ato të reflektohen në përgjegjësitë ndër-institucionale për sigurinë publike e në mënyrë të veçantë të adresohen gjatë hartimit e strategjive vendore të sigurisë publike.

Kjo aleancë bashki-polici-prokurori siç është propozuar që në takimet e para mund të vendoset në një kuadër bashkëpunimi të formalizuar. Bashkëpunimi dhe ndarja e përgjegjësisë në kuadër të trekëndëshit të “artë” mban të gjitha potencialet për parandalimin e krimit dhe zbatimin e ligjit, ku mund të përfshihen edhe lufta ndaj trafikëve e deri tek parandalimi i krimit i organizuar. Në botimet e ardhshme do të trajtojmë më gjerësisht këtë temë.

Një drejtim tjetër programor i punës sonë në vitet në vazhdim do të jetë nxitja e politikave mbështetur në evidencat për çështje që kanë të bëjnë me etikën dhe integritetin. IDM do të synojë një përfshirje sa më të plotë të kapaciteteve institucionale të policisë në këto procese me qëllim zhvillimin e politikave të qëndrueshme dhe të zbatueshme që reflektojnë mbi realitetin institucional dhe shoqëror në vend.

Së fundmi, ky buletin periodik do të përpiqet të komunikojë me përfaqësuesit e institucioneve në nivel kombëtar dhe vendor, parlamentin, akademinë e shoqërinë civile drejt arritjes së objektivave.

Mesazhet kryesore të fjalës së Ambasadores së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, znj. Guusje Korthals Altes

Projekti “Mbi përmirësimin e Integritetit të Policisë së Shtetit” është shumë i rëndësishëm për Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Ambasadën e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta. Staf i IDM-së është shumë i përkushtuar dhe entuziast për këtë projekt dhe ata kanë një strategji të qartë për të punuar mbi llogaridhënien, integritetin dhe korrupsionin në polici.

Si do të realizohet kjo?

Kjo nismë mbështetet në rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së policisë në nivel vendor si dhe rritjen e bashkëpunimit me aktorë të tjerë, median dhe publikun e gjerë.

Policia e Shtetit është institucioni kryesor kur bëhet fjalë për rendin dhe sigurinë publike dhe për këtë, integriteti është thelbësor për të rritur besueshmërinë e publikut.

Kjo vlen edhe për prokurorinë. Roli i tyre në zinxhirin e drejtësisë është garancia për zbatimin e ligjit, porta e sundimit të ligjit.

Dhe e fundit por jo më pak nga rëndësia - bashkia, detyra e së cilës shkon përtej thjesht ofrimit të shërbimeve. Ajo përfshin gjithashtu kujdesin për rendin dhe sigurinë publike, cilësi më të mirë jetese dhe lagje të pastra ku ligjet dhe rregullat zbatohen dhe qytetarët ndihen të sigurtë dhe të mbrojtur. Ajo ç’ka është më e rëndësishmja - është fakti që zëri i tyre të dëgjohet gjithmonë.

Në udhërrëfyesin për integrimin në BE, 2 nga 5 prioritetet kryesore presin që institucionet të krijojnë një historik të qëndrueshëm në: (1) luftën kundër korrupsionit dhe (2) luftën kundër krimin të organizuar.

Dy prioritete kyçe, në të cilat nuk është i rëndësishëm vetëm zinxhiri i drejtësisë, por edhe forcimi i sundimit të ligjit dhe i institucioneve të përgjegjshme si hapa vendimtarë në këtë moment për Shqipërinë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE. Gjithashtu, në këtë proces të forcimit të sundimit të ligjit dhe të institucioneve të përgjegjshme, janë thelbësorë shoqëria civile dhe publiku në tërësi.

Hollanda po ndjek nga afër progresin që Shqipëria po bën drejt hapjes së negociatave për anëtarësimin në BE, sikurse dhe mbështesim e ndihmojmë Shqipërinë- kudo që është e mundur- të arrijë qëllimin e saj. Në këtë e quajmë politikë holandeze “të rreptë dhe të drejtë”.

Kjo është arsyeja përse Ambasada e përkrah IDM-në në këtë projekt të radhës: Integriteti Policor dhe zbatimi i “trekëndëshit të artë” Polici-Bashki-Prokurori.

Në këtë kuadër jam informuar se është hera e parë që qeverisja vendore, policia dhe prokuroria së bashku po ballafaqohen me pyetjet dhe ankesat e qytetarëve.

Në javët e fundit, janë zhvilluar takime llogaridhënëse në Berat, Pogradec dhe Laç, ku ka pasur shumë interes, pyetje dhe kontribute nga publiku dhe një performancë e shkëlqyer nga shefat e policisë, prokurorët vendorë dhe kryetarët e bashkive.

Sot jemi këtu në Korçë me përfaqësues të “trekëndëshit të artë” dhe shoqërisë civile. Të gjithë jeni këtu për të ndarë mendimet dhe për të debatuar rreth proceseve duke kontribuar në këtë mënyrë në kontrollin dhe balancat në sistem.

Hollanda nuk është immune ndaj korrupsionit, asnjë vend nuk është. Rastet e fundit të korrupsionit na mësojnë se si shoqëria se duhet të jemi gjithmonë vigjilantë. Nuk mund të reshtësh kurrë luftën kundër korrupsionit, ndaj nevojitet rritja e ndërgjegjësisë dhe mundësimi i kontrollit dhe balancave. Dhe për këtë luftë keni nevojë për aleatë - shoqëria civile është një prej tyre!

Llogaridhënia mund të mos jetë një temë e lehtë apo e rehatshme, por është shumë e rëndësishme ta diskutoni atë. Çfarë do të thotë të mbash përgjegjësi, sa transparente mund dhe duhet të jenë institucionet? Vetëm duke pasur një dialog të hapur, institucionet mund të kryejnë më mirë punën, përmirësojnë rendin dhe sigurinë publike.

Prandaj, do të doja të falënderoja organizatorët (IDM) por edhe Policinë e Shtetit, Prokurorinë dhe Kryetarin e Bashkisë Korçë që mundësuan këtë debat të hapur sot.

Le të përdorim platformën e ofruar për të bërë pyetje, për të diskutuar përvojat dhe për të krijuar së bashku praktika më të mira.

Kjo hap rrugën për më shumë zhvillim.

Faleminderit!

Llogaridhënia Horizontale: Drejt forcimit dhe institucionalizimit të bashkëpunimit Polici-Bashki-Prokurori për rendin dhe sigurinë publike.

Seria e Takimeve Publike Llogaridhënëse për Parandalimin e Krimit

Policia e Shtetit ka hyrë në një proces reformash që kanë të bëjnë me hapjen dhe rritjen e bashkëpunimit të saj me institucionet në nivel vendor dhe qytetarët. Përmes një qasjeje multi-aktoriale në nivel vendor, IDM ka filluar një seri takimesh publike llogaridhënëse ku Policia-Bashkia-Prokuroria vijnë së bashku në një platformë të hapur komunikimi ndaj aktorëve të tjerë vendorë, medias dhe qytetarëve.

Bashkia vjen në këto takime me peshën e përgjegjësive të saj për më shumë shërbime dhe përgjegjësi për sigurinë publike.

Prokuroria për herë të parë ekspozohet para publikut dhe institucioneve dhe shoh veten të sigurtë në ushtrimin e përgjegjësive të saj për parandalimin e krimit.

Policia në një partneritet sa më funksional me institucionet e tjera në nivel vendor mund të rrisi impaktin e punës së saj në parandalimin dhe luftën kundër krimit. Mbështetur në këto përvoja ajo mund të ndërtojë një strategji vendore për sigurinë në komunitet që të jetë e bazuar, realiste dhe e zbatueshme.

Takimet llogaridhënëse janë ndjekur nga anëtarët e këshillave bashkiakë, përfaqësuesit e njësive administrative, fshatrave. Aktorë të rëndësishëm pjesëmarrës janë konsideruar dhe institucionet e arsimit parauniversitar, ku kanë qenë të pranishëm përfaqësues të bordeve të prindërve të shkollave të qyteteve/fshatrave, përfaqësues të këshillave të nxënësve, mësues e drejtues të institucioneve përgjegjësve për arsimin. Biznesi dhe shoqëria civile është gjithsesi një grup interesi vital i këtyre aktiviteteve.

Partneri i parë i policisë mbetet pushteti vendor

Shumë studime dhe eksperiencia të ndryshme brenda dhe jashtë vendit dëshmojnë për peshën e pazëvendësueshme që ka bashkëpunimi i policisë së shtetit me njësitë e qeverisjes vendore. Si kundër, për më tej, edhe në përvojën tonë kombëtare legjislativi ka pasur të parashikuar përgjegjshmërinë e drejtuesve të policisë ndaj institucioneve vendore e në mënyrë të veçantë këshillit bashkiak. Ndesh thuajse në të gjitha bashkitë e vendit që kur flitet për raporte bashkëpunimi dhe përgjegjshmërie midis policisë dhe pushtetit vendor iu referohemi raporteve individuale të drejtuesit të policisë me drejtuesin e bashkisë. Kjo absolutisht që është e rëndësishme. Por, marrëdhënja e suksesshme midis institucionit të policisë dhe asaj të qeverisjes vendore duhet të ndërtohet mbi një bazë dhe komunikim institucional, i cili shkon përtej nivelit të komunikimit të titullarëve.

Bëhet fjalë për një komunikim periodik që përcjell tek këshilli bashkiak një raport mbi problematiken kryesore të rendit dhe sigurisë publike në territorin e bashkisë, në mënyrë të veçantë ato për çështje që kërkojnë një vëmendje më të madhe nga institucioni i qeverisjes vendore apo që e sensibilizon këtë të fundit për fenomene kriminale në komunitet.

IDM synon të nxisë dhe mbështesë këtë formë komunikimi shkresor në lidhje me rendin dhe sigurinë publike. Përfshirja në diskutim e vendimmarrësve vendorë që përfshin anëtarët e këshillit bashkiak rrit ndërgjegjësimin, përgjegjshmërinë dhe mbështetjen e tyre në përballjen me problematika të rëndësishme të sigurisë publike.

Policia Berat: Vendorsja e një marrëdhënieje të re mes policisë dhe qytetarëve për një raport më të mirë besimi dhe kontributi në funksion të rendit dhe sigurisë.

Gjatë takimit llogaridhënës, drejtuesi i policisë vendore, Z. Artion Duka theksoi disa nga problematikat në Bashkinë Berat:

- krimet ndaj pronës, kryesisht vjedhje banesash dhe lokalesh;
- siguria në institucionet e arsimit, kryesisht parandalimi i ngjarjeve kriminale në shkolla dhe përreth tyre
- parandalimi i shpërndarjes së lëndëve narkotike;
- siguria rrugore (mungesa e sinjalistikës, respektimi i rregullave të qarkullimit)
- rastet e shtuara të dhunës në familje

Një nga risitë e përmendura në riorganizimin e policisë është dhe krijimi i Zonës Policore, që do të ofrojnë të gjitha shërbimet policore, patrullimin, hetimin e krimit, policinë rrugore, etj. Gjithashtu, pjesë e këtij organizimi është dhe N/Specialisti i Policimit në Komunitet për edukimin në shkolla.

Qasja e re në organizimin e strukturave të policisë vendore dhe bashkëpunimit korrekt me institucionet vendore dhe komunitetin është vlerësuar dhe nga institucioni i bashkisë, i cili ka theksuar se ky riorganizim ka rritur jo vetëm shkallën e besimit të saj, por dhe ka krijuar ndërkohë një frymë të re bashkëpunimi me të gjithë aktorët dhe faktorët përbërës të këtij komuniteti, në funksion të përmirësimit të sigurisë publike.

Z. Sinaj theksoi se “asnjëherë problematikat nuk janë përgjegjësi e një institucioni të vetëm, bashkë edhe me komunitetin mund t’i bëjmë më mirë gjërat. Të gjithë janë aktorë të rëndësishëm në kontributin për sigurinë publike”.

Gjatë diskutimit të hapur, përfaqësuesi i një prej Këshillat të Lagjeve sugjeroi që komunikimi më i mirë me policinë dhe bashkinë mund të vijë edhe nga kontakti i vazhdueshëm me përfaqësues të këtyre strukturave të qytetit. Këshillat e Lagjeve janë prezent në mbledhjet e këshillit bashkiak dhe janë aktivë në raportimin pranë bashkisë të problematikave të zonave përkatëse.



Pogradec: Shefi i komisariatit Z. Nikollaq Palla: “Nëse ju nuk bëni vërejtje për punën tonë, policia nuk mund të përmirësohet! Na ndihmoni që t’ju shërbejmë më mirë!”

Gjatë takimit llogaridhënës në Pogradec, shefi i komisariatit Z. Nikollaq Palla parashtrori disa aspekte të cilat mund të ndikojnë në parandalimin e kriminalitetit në zonë. Ndër to mund të përmendet nevoja për një koordinim më të mirë polici-bashki-prokurori për ndjekjen e çështjeve konkrete përmes një memorandumit bashkëpunimi. Shefi i komisariatit theksoi edhe njëherë gatishmërinë e policisë si aleat i institucioneve dhe qytetarëve për garantimin e rendit dhe sigurisë publike.

Disa nga çështjet shqetësuese të zonës janë:

- mungesa e sinjalistikës së përshtatshme rrugore
- nevoja për patrullim më të shpeshtë në orë të caktuara
- përdorimi i lëndëve narkotike në përmasa shqetësuese
- thirrje për më shumë bashkëpunim me shkollat, nxënësit, prindërit
- rritja e pranisë së policisë në zonat e thella

Nga pikëpamja e Prokurorisë Pogradec u nënvizua rëndësia e informimit të publikut për tendencat e kriminalitetit dhe rritjes së bashkëpunimit të qytetarëve me organet përkatëse. Në këtë aspekt, u theksua tendenca në rritje e kriminalitetit me natyrë kundër autoritetit të shtetit; vjedhjet; dhuna në familje, shtimi i përdoruesve të lëndëve narkotike, etj.

Gjithashtu, është i rëndësishëm të përdoret parimi i ndërmjetësimit për problematika të qytetarëve që mund të zgjidhen pa shkuar dosja në prokurori. Problematike mbetet zbulueshmëria e ulët për rastet e vjedhjeve, pasi grabitësit veprojnë në mënyrë të strukturuar.

Kryetari i Bashkisë z. Eduard Kapri theksoi bashkëpunimin pozitiv me policinë për



Pjesëmarrja e përfaqësuesit të Prokurorisë në këto takime mendoj se shërben edhe për të rifituar besimin në publik se institucionet përgjegjëse ligjzbatuese (Policia, Prokuroria, organet e qeverisjes vendore) janë të gatshëm për t’i dëgjuar, bashkëpunuar, orientuar për të zgjidhur drejt problemet e tyre dhe për t’i inkurajuar që edhe ata të jenë aktivë në procesin parandalues dhe denoncimin e shkeljeve të ligjit.

Prokurore Pogradec, Dorina Bejko

rastet e prerjes së pyjeve, ndërtimet pa leje, për dhunën në familje, etj.

Pjesëmarrësit e këtij takimi llogaridhënës ishin shumë aktivë në ngritjen e problematikave të zonës për t'u zgjidhur nga aktorët vendorë. Gjithashtu rastet e dekonspirimit nga ana e policisë kanë ndikuar në gatishmërinë e qytetarëve për të raportuar shkeljet.

Në këtë aspekt, emëruesi i përbashkët i komenteve nga pjesëmarrësit e pranishëm ishte pikërisht nevoja për rritjen e besueshmërisë reciproke midis institucioneve dhe qytetarëve.

Takimi Llogaridhënës në Kurbin: Neglizhimi i konflikteve banale çon në krime të rënda dhe në gjakmarrje

Në takimin llogaridhënës në Kurbin, Shefi i komisarariatit të policisë Kurbin z. Erdit Rreçeku, në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë z. Artur Bardhi dhe Drejtuesin e Prokurorisë së rrethit z. Arben Nika diskutuan me grupet e interesit mbi punën dhe sfidat e mëtejshme.

Problematikat e evidentuara nga policia vendore përfshijnë që nga ato infrastrukture si nevoja për mjetet e duhura për mbulimin me patrullime të të gjithë zonës, deri tek ato të kultivimit të lëndëve narkotike, krimet e pronës, gjakmarrja si dhe siguria rrugore dhe ajo në shkolla.

Ndërsa për Kryetarin e Bashkisë z. Artur Bardhi mbeten sfidë për autoritetet vendore krimet e pronës dhe fenomeni i gjakmarrjes si dhe sjellja e komunitetit ndaj pronës së përbashkët.

Në mbështetje të problematikave të evidentuara, drejtuesi i Prokurorisë veçoi nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të denoncuar dhe dëshmuar për rastet e shkeljes së ligjit.

Nga ana tjetër, shqetësuese për qytetarët shihet siguria rrugore, sidomos në oraret e qarkullimit të nxënësve dhe mungesa e aktiviteteve sportive, kulturore, orientimi profesional i të rinjve. Edhe në takimin llogaridhënës në Kurbin pjesëmarrësit evidentuan rrjedhjen e informacionit për qytetarët të cilët raportojnë shkeljet, duke minuar në këtë mënyrë edhe besimin tek institucionet vendore.

Gjithashtu, qytetarët ngritën shqetësimin e mungesës së informacionit mbi ecurinë e akteve të vjedhjeve të banesave, bankave etj nga ana e policisë. Kjo mungesë informacioni çon që komuniteti të ketë besim të ulët tek këto institucione.



Korçë: Informimi i komunitetit është thelbësor për të nxitur raportimin nga ana e qytetarëve të shkeljeve të ligjit

Në Korçë, takimi llogaridhënës solli së bashku në një panel përballë grupeve të interesit dhe qytetarëve Drejtorin e policisë së qarkut Korçë z. Lorenc Panganika, Kryetarin e Bashkisë z. Sotiraq Filo dhe Drejtuesen e Prokurorisë së rrethit znj. Dhorina Theodhori. E pranishme për të mbajtur fjalën e hapjes ishte edhe Ambasadorja e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, znj. Guusje Korthals Altes.

Prezantimi i situatës së rendit dhe sigurisë nga ana e policisë nxori në pah disa problematika si: dhuna me bazë gjinore (duke përfshirë dhunën në familje), siguria rrugore, krimet ndaj mjedisit, ndërtimet pa leje, vjedhjet e banesave, përdorimi i drogës, duhanit dhe alkoolit në shkolla. Disa nga rekomandimet e policisë për bashkinë për parandalimin e këtyre problematikave ishin:

- 1) Përmirësimi i sinjalistikës rrugore, planifikimi i sensit të rrugeve urbane;
- 2) Sigurimi i ndricimit për rrugët;
- 3) Monitorimi nga pushteti vendor i ndotjes akustike nga subjektet private.

Gjatë fjalës së tij, Kryetari i Bashkisë, Z. Sotiraq Filo, theksoi se parandalimi i krimit i intereson një grupi më të gjerë institucionesh dhe komunitetit gjithashtu.

Z. Filo nënvizoi se informimi i komunitetit është shumë i rëndësishëm për të nxitur raportimin nga ana e qytetarëve të shkeljeve të ligjit. Ky mund të jetë kontributi më i mirë i qytetarëve në parandalimin e krimit, shtoi Z. Filo.

Drejtuësja e Prokurorisë së rrethit znj. Dhorina Theodhori vlerësoi se “ky lloj takimi i hapur do t’i shërbejë thirrjes për një bashkëpunim me të madh të publikut me prokurorinë. Vetëm në këtë mënyrë, lufta ndaj korrupsionit nuk do të ngelet një luftë virtuale dhe abstrakte”.

Ndërsa Znj. Theodhori analizoi prioritetet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe veçoi si problematikë veprën penale të posedimit të substancave narkotike me qëllimin final tregun ndërkombëtar të saj, por edhe shpërndarjen dhe tregtimin e saj në sasi të vogla, por në mjaft raste tregtimi është shndërruar në një aktivitet të qëndrueshëm dhe mjaft të organizuar.

Drejtori i IDM-së, në takimin e organizuar në Korçë u shpreh se hapja e zyrave të punonjësve të policisë në njësitë e ndryshme administrative vlerësohet si ecuri positive. Kjo lehtëson kontaktet me komunitetet vendore edhe për zonat rurale, por nuk mund të zëvendësojë kontaktet e drejtpërdrejta të policisë me banorët e fshatrave. Sikundër, kontakti dhe komunikimi nuk duhet të kufizohet vetëm me kryetarin e fshatit (kryeplakun) por minimalisht, bashkëpunimi i punonjësve të policisë duhet të shtrihet me gjithë kryesinë e fshatit. Kjo rrit besueshmërinë në komunikim dhe nxit një përfitim më të madh në informacionin mbi parandalimin e krimit.





PLANI I INTEGRITETIT

Përkufizimi i kulturës policore përfshin vlerat dhe standardet që ndikojnë në modelet e sjelljes dhe praktikën e punës të punonjësve të policisë. Këto vlera dhe parime duhen brendësuar nga organizata dhe zhvillohen përgjatë historisë së saj. *(Pakoja e instrumenteve mbi integritetin policor, DCAF)*

Integriteti i organizatës ekziston kur ajo vepron në përputhje me listën e vlerave etike të përcaktuara qartë. Vlerat mund të përcaktohen, për shembull, tek vizioni i organizatës, misioni i saj, dhe kodi i etikës. Këto vlera integrohen në proceset e brendshme nga punonjësit, dhe në bashkëveprimet e organizatës me mjedisin e saj. Organizata siguron respektimin dhe bërjen të dukshme të këtyre vlerave nëpërmjet komunikimit të përshtatshëm, përmes lidershit, strategjive, politikave, rregullave dhe kontrollit, llogaridhënies dhe transparencës.

Rëndësia e Integritetit të Policisë për shoqërinë:

Respektimi i të drejtave të njeriut – Policisë i janë besuar kompetenca të veçanta të tilla si arrestimi, ndalimi, shtrëngimi dhe përdorimi i forcës. Nëse nuk përdoren me vetëpërmbytje të nivelit më të lartë dhe me integritet, këto kompetenca mund të çojnë me lehtësi në shkeljen e të drejtave të njeriut.

Ligjshmëria – Në një sistem demokratik është themelore që institucionet shtetërore të gëzojnë ligjshmëri, do të thotë që njerëzit t'i perceptojnë autoritetet publike si përfaqësues të vullnetit publik. Legjitimiteti i policisë forcohet shumë nëse publiku sheh që kompetencat e policisë përdoren për t'i shërbyer publikut me integritet, paanshmëri dhe drejtësi.

Ofrimi i një shërbimi efektiv – Shoqëritë moderne po mbështeten gjithnjë e më shumë në bashkëpunimin polici-publik për të realizuar me sukses mandatin policor. Integriteti i policisë është themelor për të krijuar besim midis publikut dhe policisë, dhe, besimi nxit prirjen e qytetarëve për të bashkëpunuar me policinë dhe për të ofruar informacion të dobishëm për parandalimin dhe shtypjen e krimit.

Ndjenja e sigurisë – Kur njerëzit besojnë se policia është e angazhuar t'i shërbejë dhe të mbrojë çdonjërin prej tyre, ata priren të ndjehen më të sigurt në jetët e tyre të përditshme.

Modelimi i rolit – Policia është agjenci shtetërore që përgjigjet për garantimin e respektimit të ligjit dhe ruajtjen e rendit moral në shoqëri. Duke shfaqur integritet në punën e tyre, zyrtarët e policisë shërbejnë si shembuj dhe modele për qytetarët e tjerë dhe nxitin respektimin e ligjit dhe të etikës.

Besimi në institucionet shtetërore – Zyrtarët e policisë janë përfaqësuesit më të dukshëm të shtetit. Imazhi i tyre pasqyron imazhin e shtetit dhe besimi në ta ndikon tek besimi i publikut në institucionet e tjera shtetërore.

Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe operacional që bazohet në rezultatet e planifikimit të integritetit dhe të procesit të vlerësimit të riskut të ndërmarrë brenda

organizatës policore. Procesi bazohet në identifikimin e shkeljeve të mundshme për pozitat e ndjeshme si dhe vlerësimi i tyre duke marrë parasysh: 1) dëmtimet materiale dhe jo materiale që mund të shkaktohen nga shkejet e mundshme, dhe 2) rezistencën organizative të praktikuar me rregullore, procedura, kode dhe praktika relevante si dhe me përfshirjen e stafit si pjesë aktive e këtij procesi.

Pilotimi i Planit të Integritetit:

Për herë të parë, organizata e Policisë së Shtetit është duke pilotuar Planin e Integritetit (PI) në Komisariatit Nr. 1 në Tiranë, i cili do të shërbejë si një mekanizëm për parandalimin e korrupsionit si dhe reduktimin e riskut të integritetit dhe parregullsive të tjera. PI po zhvillohet sipas një procesi vetëvlerësimi dhe konsiston në 5 faza: 1) Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore 2) Faza 2: Identifikimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të risqeve dhe të detyrave delikate në veprimtarinë e komisarariatit. c) Faza 3: Vlerësimi i faktorëve të riskut dhe intensitetit të riskut të identifikuar. d) Faza 4: Ndërmarrja e masave për eliminimin apo pakësimin e riskut të integritetit në nivelin e pranueshëm. e) faza 5: Zbatimi dhe Monitorimi.

Në këtë numër të Buletinit do të paraqesim komponentët e fazës së parë përgatitore.

FAZA 1: PËRGATITJA, KOMUNIKIMI DHE MOBILIZIMI I BURIMEVE NJERËZORE.

Ngritja e një Grupi Pune për Integritetin nga shefi i komisarariatit për zhvillimin e Planit të Integritetit dhe emërimi i Koordinatorit të Grupit të Punës për Integritetin (GPI). Grupi i Punës përbëhet nga përfaqësues të katër seksioneve të komisarariatit nr. 1 (seksioni i hetimit dhe parandalimit të krimeve; ruajtja dhe siguria së objekteve; patrullës së përgjithshme; policimit në komunitet). Nën drejtimin e koordinatorit, grupi i punës merr detyrat për të gjithë procesin që lidhet me përgatitjen e regjistrimit të risqeve dhe planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit.

Hartimi dhe miratimi i një programi pune për zhvillimin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimin e Planit të Integritetit (plan aktivitetesh, afat dhe përgjegjësi). Koordinator i grupit të punës informon të gjithë të punësuarit në komisarariat, aktorët publikë të interesuar; publikun dhe grupet e interesit, mbi aktivitetet e planifikuara në zhvillimin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe metodave të vlerësimit.

Koordinatori menaxhon punën e grupit të punës dhe është përgjegjës për monitorimin dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara në vendimin e kryetarit të bashkisë dhe programit të punës të miratuar nga GPI.

Komunikimi i Grupit të Punës me punonjësit e tjerë të komisarariatit mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit në komisarariat dhe procesin e vlerësimit përmes: takimeve/mbledhjeve me punonjës të komisarariatit; Publikimit të njoftimeve mbi Planin e Integritetit në këndin njoftimeve të komisarariatit; Komunikim me e-mail; Takime apo mbledhje sektoriale.

Llogaridhënia përkufizohet si një sistem i kontrolleve dhe balancave të brendshme dhe të jashtme që synojnë të garantojnë që policia të kryejë detyrat e veta në mënyrën e duhur dhe me përgjegjësi. Një sistem i tillë ka për qëllim të mbrojë integritetin e policisë dhe të parandalojë sjelljen e papërshtatshme si dhe të rrisë besimin e publikut në polici.

Integriteti policor i referohet kuadrin rregullator dhe masave të tjera që e ndalojnë policinë të keqpërdorë kompetencat e veta dhe të abuzojë me të drejtat dhe privilegjet e saj. (UNODC: Handbook on police accountability, oversight and integrity, faqe 4).

Trajnimi për Planin e Integritetit në Komisaratin Nr.1-Tiranë

Integriteti në kontekstin e veprimtarisë së Policisë duhet kuptuar në terma më të gjerë se korrupsioni, dhe që përmbledh midis të tjerash, etikën, respektimin e të drejtave të njeriut, profesionalizmin, kufizimin e përdorimit të forcës fizike, respektin ndaj qytetarëve/publikut dhe mos-diskriminimin.

Përmes një trajnimi të thelluar dy ditor mbi hartimin e Planit të Integritetit me punonjësit e policisë së Komisarimit Nr. 1, Tiranë u mundësua njohja me aktet normative të lidhura me etikën dhe integritetin edhe nëpërmjet rasteve praktike.

Një modul i rëndësishëm i trajnimit mbi ciklin e zhvillimit të Planit të Integritetit është vlerësimi i risqeve të integritetit për çdo proces/sector të institucionit të ekspozuar ndaj korrupsionit.





PRAKTIKA TË MIRA NDËRKOMBËTARE

Modeli i Aleancës së Sigurisë në Rotterdam

Në Rotterdam (Holandë) bashkitë, policia dhe zyra vendore e prokurorisë po punojnë së bashku në kuadër të Aleancës së Sigurisë së Roterdamit (VAR) për ta bërë qytetin dhe rrethinat e tij më të sigurtë. VAR shtrihet brenda rajonit si një platformë për të ndarë njohuritë dhe përvojat mbi një sërë çështjesh që lidhen me sigurinë; që përfshin sigurinë e jetesës, të të rinjve, krimin kibernetik, dhunën dhe radikalizimin. Gjithashtu, VAR mbështet bashkëpunimin lokal ndërmjet partnerëve duke i lidhur autoritetet me njëra-tjetrën, duke nxitur mundësi për të punuar së bashku dhe sinjalizimin e problematikave.

Bashkëpunimi trepalësh në nivel vendor mundëson që disa nivele të qeverisjes të bashkohen dhe të bashkëpunojnë në çështjet e sigurisë që janë specifike për qytetin, duke bërë të mundur një përgjigje më të shpejtë në rast të një shkeljeje. VAR organizon workshope dhe trajnime për stafin e institucioneve të përfshira, si një sesion trajnimi të kohëve të fundit mbi dhunën në familje për rreth 70 drejtorë dhe punonjës të bashkive, policisë dhe të Prokurorisë.

Aleanca ka dhënë tashmë rezultate pozitive. Gjatë disa viteve të fundit, numri i krimeve në rajon ka rënë. Në gjysmën e parë të vitit 2018, numri total i krimeve të regjistruara në njësinë e Roterdamit ra me 14% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kishte më pak raste të vjedhjeve (të automjeteve dhe / ose shtëpive), dhunës në familje dhe krime të dhunshme në rrugë.

Ndarja e detyrave mbi sigurinë mund të jetë komplekse dhe e ndryshme, por përvoja e Roterdamit tregon se kjo është e ndryshueshme. Bashkëpunimi është një mënyrë efektive për rritjen e llogaridhënies vendore dhe trajtimin e çështjeve të sigurisë së bashku me qeverisjen vendore, policinë, prokurorinë dhe partnerët e tjerë në një kontekst lokal.

POLICI

BASHKI

PROKURORI

INTEGRITET



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands